



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Ekstra IV

Gusht

2002

Akte të Papublikuara

Korrik 1999-Tetor 1999

		Faqe
Vendim i K.M nr.305, datë 1.7.1999	Për marrëdhëniet ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe drejtorive të marrëdhënieve me jashtë pranë dikastereve.....	5
Vendim i K.M nr.307, datë 1.7.1999	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.768, datë 8.12.1998 “Për cakimin e përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës”.....	6
Vendim i K.M nr.310, datë 1.7.1999	Për mbështetjen financiare për vitin 1999 të komisioneve të tokës në fshatra dhe komuna.....	6

Vendim i K.M nr.311, datë 5.7.1999	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.288, datë 18.6.1999 "Për miratimin e dokumentit të politikave të zhvillimit të sektorit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë".....	7
Vendim i K.M nr.313, datë 8.7.1999	Për shpalljen e ‘Urës së Matit’ monument kulture	8
Vendim i K.M nr.315, datë 8.7.1999	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.150, datë 3.4.1993 “Për financimin e projekteve kulturore, artistike, të personave fizikë e juridikë, vendas e të huaj”.....	8
Vendim i K.M nr.321, datë 5.7.1999	Për miratimin e shpërndarjes së fondeve, sipas rretheve, procedurat e miratimit të familjeve që përfitojnë dhe kushtet e dhënies së kredisë, në kuadrin e kredis greke për strehimin.....	9
Vendim i K.M nr.327, datë 12.7.1999	Për dhënien e fondeve buxhetore për skemën e trajtimit me strehim të funksionarëve politikë dhe të nënpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore.....	12
Vendim i K.M nr.331, datë 15.7.1999	Për pagat e punonjësve civilë të sistemit të burgjeve.....	12
Vendim i K.M nr.333, datë 15.7.1999	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.197, datë 18.3.1996 “Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore”.....	13
Vendim i K.M nr.336, datë 15.7.1999	Për një shtetsë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.78, datë 21.1.1999 “Për ruajtjen e pronësisë shtetërore në disa shoqëri tregtare dhe ndërmarrje”.....	13
Vendim i K.M nr.337, datë 15.7.1999	Për krijimin e komisionit qeveritar për problemet ujore me vendet fqinjë.....	14
Vendim i K.M nr.343, datë 21.7.1999	Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit rrugor.....	15
Vendim i K.M nr.344, datë 21.7.1999	Për trajtimin me shtesë mbi pagën bazë për natyrë të veçantë pune e shërbimi të ushtarakëve që shërbejnë në strukturën e “Batalionit special të brigatave komando”.....	16
Vendim i K.M nr.346, datë 29.7.1999	Për shpronësim për interes publik të një trualli me sipërfaqe 970m ² në Parkun e Madh të Tiranës.....	16

Vendim i K.M nr.347, datë 28.7.1999	Për ndarjen e fondeve të kredisë greke për programet e infrastrukturës sociale.....	17
Vendim i K.M nr.350, datë 28.7.1999	Për miratimin e dhënies me koncesion të minierave të kromit në Vlahna, Perollaj dhe Kalimash, së bashku me fabrikën e pasurimit.....	17
Vendim i K.M nr.351, datë 28.7.1999	Për miratimin e kuotave të ushqimit në spitalet ushtarake...	18
Vendim i K.M nr.352, datë 28.7.1999	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.204, datë 26.3.1998, "Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit lokal".....	20
Vendim i K.M nr.354, datë 28.7.1999	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.520, datë 21.8.1998 "Për miratimin e procesverbalit të komisionit të përbashkët italo-shqiptar".....	20
Vendim i K.M nr.355, datë 28.7.1999	Për miratimin e projektit "Shqipëria 2000" për rehabilitimin e institucioneve arsimore.....	22
Vendim i K.M nr.358, datë 28.7.1999	Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve të doganave.....	24
Vendim i K.M nr.362, datë 4.8.1999	Për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të sigurimit, të bashkërendimit dhe të grupit të gatshëm të policisë, për asetet e shoqërive huamarrëse.....	27
Vendim i K.M nr.380, datë 12.8.1999	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.32, datë 25.1.1999 "Për dhënien në enfiteozë të ndërmarrjes së prodhimit të celikut Elbasan".....	27
Vendim i K.M nr.384, datë 28.7.1999	Për miratimin e programit "Për disa masa për fuqizimin e rendit dhe të sigurisë publike".....	28
Vendim i K.M nr.392, datë 12.8.1999	Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 1.9.1992 'Për ish-të dënuarit dhe ish-të përndjekurit politikë'.....	35
Vendim i K.M nr.404, datë 26.8.1999	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.78, datë 21.1.1999 'Për ruajtjen e pronësisë shtetërore në disa shoqëri tregtare dhe ndërmarrje'.....	36
Vendim i K.M nr.407, datë 31.8.1999	Për privatizimin me ankand pa çmim fillestar të paketave shtetërore të aksioneve të disa shoqërive tregtare.....	36

Vendim i K.M nr.409, datë 31.8.1999	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.418, datë 9.7.1998 “Për procedurat e likuidimit të ndërmarrjeve të falimentuara në rrugë administrative.....	37
Vendim i K.M nr.413, datë 3.9.1999	Për “hapjen e llogarisë “Për financimin e projektimit dhe të ndërtimit të aksit rrugor Durrës – Kukës – Qafë Morinë””	38
Vendim i K.M nr.415, datë 26.8.1999	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.791, datë 24.12.1998 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.694, datë 21.10.1996 “Për normën mësimore e shkencore në shkollat e larta dhe në arsimin parauniversitar, pagimin e orëve suplementare, aktivizimin e pensionistëve dhe punonjësve të jashtëm në sistemin e arsimit””	38
Vendim i K.M nr.437, datë 9.9.1999	Për shpalljen projekt kombëtar të “Studimit rajonal të zhvillimit të hapësirës Tiranë – Durrës”.....	39
Vendim i K.M nr.438, datë 15.9.1999	Për rritjen e çmimeve të shitjes me pakicë të teksteve të arsimit shkollor, parauniversitar.....	41
Vendim i K.M nr.440, datë 9.9.1999	Për strukturën dhe pagat e punonjësve të policisë së ndërtimit.....	42
Vendim i K.M nr.443, datë 16.9.1999	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.786, datë 17.12.1998, "Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar, dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimor".....	43
Vendim i K.M nr.444, datë 16.9.1999	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 1.1.1996 “Për rregullat e prokurimit publik”.....	44
Vendim i K.M nr.470, datë 6.10.1999	Për krijimin dhe funksionimin e Komisionit Qeveritar të Luftës kundër Korrupsionit.....	45

V E N D I M
Nr. 305, datë 1.7.1999

**PËR MARRËDHËNIET NDËRMJET MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME DHE
DREJTORIVE TË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË PRANË DIKASTEREVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 3 ligjit nr. 8370, datë 9.7.1998 “ Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtoritë e marrëdhënieve me jashtë pranë dikastereve e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në lidhje e në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

2. Drejtoritë e marrëdhënieve me jashtë pranë dikastereve kanë për detyrë:

- të informojnë menjëherë Ministrinë e Punëve të Jashtme për të gjitha problemet, me karakter politik dhe ekonomik, që dalin gjatë takimeve të drejtuesve të dikasterit me përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë, apo nga letrat e mesazhet, që autoritetet e huaja i dërgojnë titullarit të dikasterit;

- në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, të organizojë takimet e titullarit të dikasterit me homologët e tij brenda dhe jashtë vendit;

- të organizojë protokollin e takimeve të titullarit me delegacione të huaja apo me përfaqësues të trupit diplomatik, të akredituar në vendin tonë;

- të informojë në çdo tre muaj për planin e vizitave të delegacioneve, të kryesura nga titullari apo nga zyrtarë të lartë të dikasterit, si dhe të delegacioneve homologe, të huaja, që do të vizitojnë vendin;

- të dërgojë çdo 3 muaj, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, një raport të hollësishëm për të gjitha veprimtaritë me jashtë të dikasterit, duke përfshirë edhe ecurinë e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe;

- të realizojë procedurat e brendshme dhe të marrë pjesë në përgatitjen e marrëveshjeve, protokolleve dhe të programeve dypalëshe, që nënshkruhen nga titullari;

- të kontaktojë rregullisht me drejtorinë e protokollit të shtetit, për të marrë miratimin për ftesat që i vijnë titullarit, për pjesëmarrjen në pritjet, me rastin e festave kombëtare, të organizuara nga përfaqësitë e huaja, të akredituara në Republikën e Shqipërisë;

- të mbajë letërkëmbim me përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, duke vënë në dijeni Ministrinë e Punëve të Jashtme.

3. Ministria e Punëve të Jashtme ka për detyrë:

- të ndihmojë, me materiale politike dhe ekonomike, përgatitjen e vizitave dhe të takimeve të planifikuara të titullarëve të dikastereve;

- të ndihmojë, në aspektin protokollar, organizimin e vizitave në nivelin e titullarit të dikasterit;

- të japë këshillat e nevojshme për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare;

- të transmetojë, pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë, kërkesat që vijnë nga dikasteret e ndryshme e që ajo i gjykon të arsyeshme.

4. Drejtuesit e drejtorive të marrëdhënieve me jashtë i propozohen organit të emërtesës nga titullari i dikasterit përkatës dhe nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 307, datë 1.7.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR. 768, DATË 8.12.1998 “PËR ÇAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE TË
PUNËMARRËSVE DHE PUNËDHËNËSVE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 200 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1998 “Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 768, datë 8.12.1998, në pikën 1, në titullin “Përfaqësues të organizatave të punëmarrësve” bëhen këto ndryshime :

“PËRFAQËSUES TË ORGANIZATAVE TË PUNËMARRËSVE

- | | |
|---|--------------------------------|
| 1. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë | (BSPSH) 4 anëtarë, 4 kandidatë |
| 2. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë | (KSSH) 4 anëtarë, 4 kandidatë |
| 3. Unioni i Sindikatave të Punonjësve të Shqipërisë | (USPSH) 1 anëtar, 1 kandidat. |
| 4. Sindikata e Pavarur i Minatorëve të Shqipërisë | (SPMSH) 1 anëtar, 1 kandidat” |
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 310, datë 1.7.1999

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR VITIN 1999
TË KOMISIONEVE TË TOKËS NË FSHATRA DHE KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, në buxhetin e miratuar për vitin 1999, i shtohen 10 (dhjetë) milionë lekë për shpërblimin e punës së komisioneve të tokës në fshatra dhe komuna.
Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
2. Fondi të kalojë në buxhetin e rretheve përkatëse, sipas përcaktimit që do të bëjë Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.
3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal dhe këshillat e rretheve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

KËSHILLI I RRETHIT TIRANË
BASHKIA TIRANË

KOMUNA KASHAR

Lista e personave, pronat e të cilëve do të shpronësohen si rezultat i zgjerimit të seksionit rrugor Kthesa e Kamzës-Zogu i Zi (Hyrja e Tiranës)

	EMËR ATËSIA MBIEMËR	Sip.m2	Çmimi lek/m2	Vlera totale lekë
1	Halil dhe Myslym Karapici	590	4660.2	2749518
2	Gafurr Dibra	151	4660.2	703690.2
3	Në proces	132	4660.2	615146.4
4	Në proces	193	4660.2	899418.6
5	Xhelo Dibra	900	4660.2	4194180
6	Alqi Hobdari	311	4660.2	1449322.2
7	Emrulla Gjata	256	4660.2	1193011.2
8	Banka Islamike	4108	4660.2	19144101.6
9	Nazmi Qazim Daja	467	4660.2	2176313.4
10	Mereme Gjinali	111	4660.2	517282.2
11	Miljam Hajrulla Prespa	208.75	4660.2	
12	Burhan Xhavit Berisha	1661.5	4660.2	
13	Në proces	167	4660.2	
14	Myzejen Mustafa Bylyku	417.5	4660.2	
15	Mehmet Ibrahim Bylyku	417.5	4660.2	
16	Bedrie Ali Bylyku	375.75	4660.2	
17	Naxhie Isuf Bylyku	375.75	4660.2	
18	Ibrahim Abdulla Xhemnica	1244	4660.2	
19	Isuf Dalip Lleshi	434	4660.2	
20	Bukurie Ali Bezhani	488.25	4660.2	
21	Sanie Qazim Doda	542.5	4660.2	
22	Ahmet Mustafa Kaziu	2500	4660.2	
23	Në proces	460	4660.2	
24	Në proces	460	4660.2	
25	Në proces	60	4660.2	
26	Në proces	60	4660.2	
	Totali	7891.5	4660.2	83379218.3

V E N D I M
Nr. 311, datë 5.7.1999

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 288, DATË 18.6.1999 “PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË TELEKOMUNIKACIONEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në pikën 3 pas paragrafit të dytë, në dokumentin i cili i bashkëlidhet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 18.6.1999, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

“ALBTELECOM sh.a. në marrëveshjen e lidhur me NEW WORLD TELECOM LLC të pranojë kushtin e kërkuar nga kjo shoqëri, si vijon:

“ Seksioni i 12 ekskluziviteti dhe jokonkurRenca:

Asnjë palë ose filial i cilësdo palë (qoftë duke vepruar vetëm, në partneritet ose me ndonjë ndërmarrje të përbashkët ose ndryshe): (i) nuk do t’i paraqesë ndonjë ofertë ndonjë autoriteti qeveritar,

në lidhje me mundësitë; (ii) në çdo mënyrë nuk do t'u sigurojë mbështetje personave të interesuar në lidhje me mundësitë; ose (iii) nuk do të hyjnë në ndonjë marrëveshjeje tjetër, që mendohet, në mënyrë të arsyeshme, të konkurrojnë me shoqërinë ose ndonjë filial të shoqërisë në Shqipëri. Asnjëra nga palët e kësaj marrëveshjeje nuk do të marrë pjesë në ndonjë veprimtari biznesi në Shqipëri, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në konkurrencë me shoqërinë në ndonjë biznes që shoqëria ka në përputhje me këtë marrëveshje dhe në bazë të ndonjë marrëveshjeje tjetër të përbashkët të ALBTELECOM-it dhe NWT-së, vendosur për të ndërmarrë, duke përfshirë, por pa u kufizuar te mundësitë””.

2. ALBTELECOM, sh.a. për detyrimet që ka, sipas pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 18.6.1999, për të lidhur së paku katër linja në komunë, ka të drejtë të bashkëpunojë me operatorë të tjerë vendorë, ruralë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 313, datë 8.7.1999

PËR SHPALLJEN E “URËS SË MATIT” MONUMENT KULTURE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 7867, datë 10.12.1994 “Për mbrojtjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen “Monument culture” të “Urës së Matit”, për vlerat e saj unike në historinë e konstruksioneve të urave në Shqipëri.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 315, datë 8.7.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 150 DATË 3.4.1993 “PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE, TË PERSONAVE FIZIKË E JURIDIKË, VENDAS E TË HUAJ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private e të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 3.4.1993 “Për financimin e projekteve kulturore, artistike, të personave fizikë juridikë, vendas e të huaj”, pika 1 ndryshon si vijon:

“Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve financon, me mjete pune e financiare, për realizimin e projekteve kulturore, artistike, rinore e sportive, persona fizikë e juridikë, vendas e të huaj.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, përveç kategorive të subjekteve të lartpërmendura, ka të drejtë të financojë edhe ata shtetas shqiptarë, të fushës së artit, kulturës, rinisë dhe sporteve, të cilët paraqesin projekte që i shërbejnë promovimit të vlerave artistike, kulturore, rinore e sportive, kombëtare.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 321, datë 5.7.1999

**PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË FONDEVE, SIPAS RRETHEVE, PROCEDURAT
E MIRATIMIT TË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË DHE KUSHTET E DHËNIES SË
KREDISË, NË KUADRI E KREDISË GREKE PËR STREHIMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 634, datë 8.10.1998 “Për miratimin, në parim, të platformës së përdorimit të fondeve të kredisë greke për programin e strehimit”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe të Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Fondi prej 5 miliardë dhrahmish greke, i dhënë për qeverinë shqiptare, sipas marrëveshjes së kredisë greke për programin e strehimit, të përdoret për blerje banesash në tregun e lirë dhe për investime banesash të reja, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Listat e familjeve të pastreha, që humbën banesat nga rënia e skemave piramidale, të cilat do të përfitojnë banesë sipas këtij vendimi, të hartohen dhe të miratohen nga organet e pushtetit vendor, duke marrë për bazë numrin dhe renditjen e familjeve, të cilat kanë paraqitur kërkesat përkatëse pranë këtyre organeve.

Familjet e pastreha, që përfitojnë kredi, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jenë të njohura si familje të pastreha, të plotësojnë kushtet e pikës 2/a,b të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 585, datë 11.12.1997;

- të mos jenë subjekt i TVSH-së;

- të mos kenë në pronësi pasuri të paluajtshme.

3. Enti Kombëtar i Banesave (EKB), i ngarkuar për menaxhimin e procesit të projektimit, të ndërtimit dhe të blerjes së banesave nëpërmjet kësaj kredie, të kryejë të gjitha procedurat për përzgjedhjen e shoqërive ndërtuese, lidhjen e kontratave, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e punimeve deri në përfundim dhe marrjen në dorëzim të banesave, që do të ndërtohen apo do të blihen në tregun e lirë të banesave.

4. Vendimi i këshillit të bashkisë/komunës, së bashku me listat e familjeve që përfitojnë kredi, sipas pikës 2 të këtij vendimi, nëpërmjet këshillit të rrethit dhe këshillit bashkiak, për Bashkinë e Tiranës, duhet të dorëzohen pranë Ministrisë së Pushtetit Lokal, brenda datës 10.8.1999.

Pranë organeve të pushtetit vendor të ngrihen grupe pune për verifikimin e gjendjes së strehimit të familjeve të përfshira në lista.

5. Ministria e Pushtetit Lokal të verifikojë listat e paraqitura nga organet e pushtetit vendor pranë Grupit të Mbikëqyrjes së Fajdeve brenda datës 30.8.1999 dhe t'i dorëzojë ato, pas verifikimit, pranë Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

6. Ngarkohen këshillat e rretheve, bashkitë dhe komunat të sigurojnë sheshet e ndërtimit, në përputhje me numrin e apartamenteve që do të ndërtohen në rrethin e tyre.

7. Familjet përfituese të kredisë marrin në dorëzim apartamentin nga Banka e Kursimeve

vetëm pasi kryefamiljari të ketë lidhur kontratën e shitblerjes me këtë bankë, e cila ka rolin e agjentës së qeverisë shqiptare për zbatimin e marrëveshjes së kredisë. Kryefamiljari apo personi që përfaqëson familjen përfituese të kredisë u nënshtrohet rregullave të Bankës së Kursimeve për shlyerjen e kësaj kredie.

Kushtet e dhënies së kredisë janë:

- Afati i shlyerjes së kredisë 25 vjet.
- Interesi vjetor i kredisë 9 për qind, në monedhën lek shqiptar.

Kredia do të jepet dhe do të shlyhet në lek shqiptar.

- Për banesat që ndërtohen, çmimi i shitjes llogaritet në monedhën lek shqiptar, bazuar në vlerën në lekë të investimit në çastin e marrjes në dorëzim nga EKB-ja.

- Për banesat që do të blihen nga tregu i lirë i banesave, çmimi i shitjes do të llogaritet në monedhën lek shqiptar, bazuar në vlerën e banesës në çastin e blerjes nga EKB-ja.

- Blerja e banesave nga tregu i lirë të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.160, datë 3.4.1995 “Për kriteret e bjerjes dhe të shitjes së apartamenteve nga EKB-ja në tregun e lirë të banesave”.

- Shlyerja e vlerës së apartamenteve nga blerësi të bëhet pranë Bankës së Kursimeve me këste mujore, ku kusht për lidhjen e kontratës të jetë pagesa e kështit të parë në masën 3 për qind të vlerës së apartamentit.

- Familjet që do të përfitojnë nga kjo kredi duhet të sigurojnë të ardhura mujore jo më të vogla se 6000 lekë për frymë.

8. Shpenzimet administrative të EKB-së dhe të Bankës së Kursimeve për zbatimin e marrëveshjes së kredisë greke, si dhe shpenzimet për studim-projektimin dhe për infrastrukturën do të përcaktohen nga Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit. Ky fond përballohet nga Këshilli i Ministrave, nga fondi rezervë për vitin 1999 dhe nga buxheti i shtetit për vitet në vazhdim.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Pushtetit Lokal, EKB-ja, Banka e Kursimeve dhe organet e pushtetit vendor për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Lidhja Nr.1

Nr.	Rrethi	Fondi për blerje	Fondi për ndërtim
1	Berati	18054	
2	Bulqiza	2310	
3	Devolli	1033	
4	Delvina*	2066	
5	Dibra	9629	
6	Durrësi		103824
7	Elbasani	32257	
8	Fieri		332509
9	Gramshi	9620	
	Gjirokastrë		29179
1	Hasi	1033	
2	Kavaja	4333	
3	Kolonja	4200	
4	Korça	7035	
	Kruja	6615	
	Kuçova	13650	
	Kukësi	13125	
	Lezha	14070	

	Laçi	8085	
	Librazhdi	8085	
	Lushnja	31256	
	Mallakastër		82788
	Mati	6720	
	M. Madhe*	1033	
	Mirdita*	3465	
	Peqini*	2625	
	Përmeti	4410	
	Pogradeci	1785	
	Puka	1995	
	Saranda*	3255	
	Skrapari	9240	
	Shkodra	11865	
3	Tepelena	4305	
4	Tirana (Bashkia)		831485
5	Tirana (Rrethi)		2502
6	Tropoja*	3570	
7	Vlora		782414
	T o t a l i	240724	2164701

* Për këto rrethe mungojnë vlerat e tregut të lirë të banesave dhe për këtë arsye janë dhënë vlera të përafërta me rrethe analoge

V E N D I M
Nr. 327, datë 12.7.1999

**PËR DHËNIEN E FONDEVE BUXHETORE PËR SKEMËN E TRAJTIMIT
ME STREHIM TË FUNKSIONARËVE POLITIKË DHË TË
NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SË LARTË
SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 8095 datë 21.3.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 8439, datë 29.12. 1998 “Për Buxhetin e shtetit të vitit 1999”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave të përdoren 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për skemën e trajtimit me strehim të funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore.

2. Ky fond të transferohet në Bankën e Kursimeve, e cila ngarkohet për zbatimin e rregullave në përputhje me kriteret, termat dhe procedurat e përfutimit të kredisë të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 5.3.1999 “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 331, datë 15.7.1999

PËR PAGAT E PUNONJËSVE CIVILË TË SISTEMIT TË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8321, datë 2.4.1998 “Për Policinë e Burgjeve”, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 22.4.1999 “Për rritjen e pagave të punonjësve të institucioneve buxhetore”, lidhja nr.1, ndarja B4 shtohet emërtimi:

“Drejtor në burgje dhe institucione riedukimi”

Në lidhjen II-5 “Emërtime të tjera në Ministrinë e Drejtësisë” shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“Drejtor në burgje dhe institucione riedukimi B4.”.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992, pikës 19 i shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Punonjësit civil të sistemit të burgjeve i jepet deri në 70 për qind shtesë mbi pagën bazë mujore, për natyrë të veçantë pune.”

3. Efektet financiare të përballohen nga fondet buxhetore, të dhëna për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 333, datë 15.7.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR. 197, DATË 18.3.1996 “PËR RRJETIN E INSTITUCIONEVE
SHKENCORE SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr. 7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 197, datë 18.3.1996 “Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore”, në lidhjen I, Instituti i Studimeve dhe i Projektmeve Mekanike (ISPM) dhe Byroja e Studimeve dhe Projektmeve të Industrisë së Drurit (BSPID) shkrihen në një person juridik të vetëm.

2. Krijohet Instituti i Studimeve dhe i Projektmeve të Mekanikës dhe të Drurit (ISPMD), me qendër në Tiranë, i cili do të varet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

3. Veprimtaria kërkimore, shkencore, objekti, mjetet kryesore, baza materiale dhe arkivi i Institutit të Studimeve dhe të Projektmeve Mekanike dhe Byroja e Studimeve dhe e Projektmeve të Industrisë së Drurit i kalojnë Institutit të Studimeve dhe Projektmeve Mekanike dhe të Drurit.

4. Selia e Institutit të Studimeve dhe Projektmeve Mekanike të jetë në mjediset ku ndodhet Instituti i Studimeve dhe Projektmeve Mekanike të Drurit, pranë Institutit të Teknologjisë Minerare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 336, datë 15.7.1999

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 78,
DATË 21.1.1999 “PËR RUAJTJEN E PRONËSISË SHTETËRORE NË DISA
SHOQËRI TREGTARE DHE NDËRMARRJE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën që i bashkëlidhet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 21.1.1999, të bëhet shtesa e mëposhtme:

Emri i ndërmarrjes	Vendndodhja	Varësia	Statusi	% e pjesmarrjes shtetërore në kapital
Ndërmarrja e kripës	Vlorë	Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	Në transformim	100 %

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 337, datë 15.7.1999

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT QEVERTAR PËR PROBLEMET UJORE
ME VENDET FQINJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 paragrafi 4 të ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komisionit të përhershëm qeveritar për problemet ujore me vendet fqinj (Serbi, Mali i Zi, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Greqi, Itali).
2. Komisioni të ketë në përbërje përfaqësues nga:

- | | |
|---|---------|
| - Ministria e Punëve Publike dhe Transportit | kryetar |
| - Ministria e Punëve të Jashtme | anëtar |
| - Ministria e Rendit Publik | anëtar |
| - Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë | anëtar |
| - Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit | anëtar |
| - Ministria e Pushtetit Lokal | anëtar |

- | | |
|--|--------|
| - Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit | anëtar |
| - Agjencia Kombëtare e Mjedisit | anëtar |
| - Akademia e Shkencave | anëtar |
| - Sekretariati teknik i këshillit kombëtar të ujit | anëtar |

3. Titullarët e ministrive dhe të institucioneve të lartpërmendura të emërojnë përfaqësuesit e tyre në komision, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Komisioni të kryesohet nga Zëvendësministri i Punëve Publike dhe Transportit.

4. Komisioni të shqyrtojë dhe të hartojë projektet e marrëveshjeve, të statuteve dhe të rregulloreve me secilin vend fqinj, duke trajtuar në to të gjitha problemet e ekonomisë ujore, që ka Republika e Shqipërisë me këto vende.

5. Për probleme specifike që mund të lindin, komisioni krijon nënkomisione me ekspertë përkatës.

6. Veprimtaria e komisionit të mbështetet në legjislacionin shqiptar, si dhe në marrëveshjet e konventat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

7. Fondi për shpenzimet e veprimtarisë së komisionit dhe të nënkomisioneve (pagesat, transporti, dietat etj.) përballohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

8. Për rastet e punimeve të nevojshme studimore, fondi përkatës miratohet nga Këshilli i Ministrave.

9. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 343, datë 21.7.1999

PËR KRIJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 25 të “Kodit Civil”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, me qendër në Tiranë dhe me emër të shkurtuar DPSHTRR.

2. Objekti i veprimtarisë së kësaj drejtorie të jetë shërbimi ndaj subjekteve, shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor, për regjistrimin e mjeteve, për ndërrimin e pronësisë së tyre, pajisjen me targa, për kontrollin teknik të mjeteve, për pajisjen e mjeteve me leje-drejtimi, për ngritjen dhe informatizimin e regjistrit kombëtar të mjeteve e të drejtuesve të mjeteve dhe për transmetimin e menjëhershëm të të dhënave të kërkuara nga policia e rendit, si dhe dhënien e licencave.

3. Kjo Drejtori do të jetë institucion shtetëror, me statusin e personit juridik, publik, i cili do të vetëfinancohet.

4. Kompetencat, detyrat dhe të drejtat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të

Transportit Rrugor dhe të drejtorive rajonale përcaktohen në statutin e kësaj Drejtorie, e cila miratohet nga Ministri.

5. Emërimi i drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor bëhet nga Kryeministri me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

6. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Rendit Publik të marrin masat për kalimin në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të veprimtarisë së rregjistrimit të mjeteve, të pajisjes së drejtuesve të mjeteve me leje-drejtimi, si dhe të kartotekës e të personelit përkatës, sipas afateve dhe mënyrës së përcaktuar në marrëveshjen ndërmjet tyre.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Rendit Publik me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 344, datë 21.7.1999

PËR TRAJTIMIN ME SHITESË MBI PAGËN BAZË PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE E SHËRBIMI TË USHTARAKËVE QË SHËRBEJNË NË STRUKTURËN E “BATALIONIT SPECIAL TË BRIGADAVE KOMANDO”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ushtarakët aktivë të Batalionit Special të Brigadave Komando, të trajtohen me deri 300 për qind shtesë mbi pagën bazë mujore, për natyrë të veçantë pune e shërbimi.

2. Kriteret dhe shkallëzimi i kësaj shtese, sipas funksioneve organike të kësaj strukture, të bëhet nga Ministria e Mbrojtjes.

3. Ushtarakët që trajtohen me këtë vendim nuk përfitojnë shtesë mbi pagën bazë për vështirësi vendi e shërbimi, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 27.2.1992.

4. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.2.1999.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 346, datë 29.7.1999

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË NJË TRUALLI ME SIPËRFAQE 970 M2 NË PARKUN E MADH TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 7848, datë 25.7.1994 “Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme, në pronësi të z. Paulin Markaj,

me sipërfaqe 970 m2, për qëllime strategjike, të mbrojtjes kombëtare e të rendit publik, me vendndodhje në Parkun e Madh të Tiranës, në territorin e Bashkisë së Tiranës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Rendit Publik.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme i cili shpronësohet kompensohet me vlerë të plotë, me 6 840 440 (gjashtë milionë e tetëqind e dyzet mijë e katërqind e dyzet) lekë.

4. Fondi për kompensimin e pronarit të pasurisë së paluajtshme që do të shpronësohet të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.12.1999.

6. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 347, datë 28.7.1999

PËR NDARJEN E FONDEVE TË KREDISË GREKE PËR PROGRAMET E INFRASTRUKTURËS SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 470, datë 3.11.1997 “Për miratimin e protokollit të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Shuma prej 5 bilionë GDR-sh, e dhënë për programet e infrastrukturës sociale, të ndahet si vijon:

bazë;

- 1,5 bilionë GDR për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për përmbushjen e shërbimeve

- 1,5 bilionë GDR për Ministrinë e Rendit Publik, për strehim;

- 1 bilion GDR për Ministrinë e Mbrojtjes, për strehim;

- 1 bilion GDR për Ministrinë e Shëndetësisë, për rimëkëmbjen e infrastrukturës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 350, datë 28.7.1999

PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME KONCENSION TË MINIERAVE TË KROMIT NË VLAHNA, PEROLLAJ DHE KALIMASH, SË BASHKU ME FABRIKËN E PASURIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Minierat e kromit në Vlahna, Perollaj dhe Kalimash, së bashku me fabrikën e pasurimit, t'i jepen me koncension shoqërisë turke "Hayri Ogelman Mademcilik", sipas projektit të pakërkuar, propozuar nga kjo shoqëri.

2. Forma e kontratës koncensionare të jetë BOT (ndërtim, shfrytëzim, transferim).

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit si organi i autorizuar shtetëror për negociimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 351, datë 28.7.1999

PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË USHQIMIT NË SPITALET USHTARAKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e kuotës së ushqimit për spitalet ushtarake dhe infermieritë (për Spitalin Qendror të Ushtrisë dhe qendrat e tjera spitalore, në varësi të njësive ushtarake), sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të përcaktojë normat në natyrë, sipas vlerave kalorike të miratuara në lidhjen nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Efektet financiare të përballohen nga Ministria e Mbrojtjes, nga buxheti i vitit 1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

DIETA E QULLËT (1/2 e lëngët)

Duhet të përmbajë: 2100 kkal (prot. 80 g, lipide 12 g, glicide 297 g)

Përdorimi: Në fazën post operatore në të sëmurët me mungesë dëshire për t'u përthypur e gëlltitur, në sëmundjet psiqike me anoreksi nervore, gjendjet febrile e të zgjatura të shoqëruara me anoreksi, sëmundjet e fytyrës e ezofagut, stomakut (ushqimet e forta grimcohen dhe përpunohen).

Kuota fin. ditore: 189 lekë

DIETA HEPATOPATIKE NË FAZËN AKUTE E SUBAKUTE

Duhet të përmbajë: 2000 kkal (prot. 90g, lipide 50g, glucide 322g)

Kuota fin. ditore: 144 lekë

DIETA BLANDA

Duhet të përmbajë: 2000 kkal (prot. 82 g, lipide 16 g, glucide 256 g)

Përdorimi: Në disa forma depresive në gastritet, gastroduodenitet, në kolecistopatite pas

interventeve kirurgjikale në stomak, abdomen, laléciste, herni hiatale.

Kuota fin. ditore: 132 lekë

DIETA PËR ULCEROZËT HIPO E NORMOKALORIKE

Hipkalorike

Duhet të përmbajë: 1800 kkal (prot. 80g, lipide 57g, glucide 265 g)

Kuota fin. ditore: 340 lekë

Normokalorike

Duhet të përmbajë: 1600 kkal (prot. 99g, lipide 90g, glucide 370g)

Kuota fin. ditore: 222 lekë

Përdorimi: Në gastritet hiperacide në ulçerat gastrike e duodenale në fazën aktive pa hemoragji, në fazën aktive si dhe cikatrizimit.

DIETA PËR ENERO-KOLITE

Duhet të përmbajë: 2000 kkal (prot. 70g, lipide 63g, glucide 308 g)

Përdorimi: Për gastroenterite, colite, enerokolite.

Kuota fin. ditore: 151 lekë

KUOTA E USHQIMIT PËR SPITALET USHTARAKE

Kuota ditore e ushqimit në spitalet ushtarake të jetë:

DIETA NORMALE

Duhet të përmbajë: 2700 kkal (prot. 100g, lipide 77g, glucide 420 g)

Përdorimi: Në pacientë me aparat tretës normal

Kuota fin. ditore: 196 lekë

DIETA HIDRIKE A

Duhet të përmbajë: 102 kkal (prot. 3.5g, lipide 9.8g, glucide 0)

Përdorimi: Pas interveneteve kirurgjikale në abdomen dhe në sindromën.

Kuota fin. ditore: 202 lekë

DIETA HIDRIKE B-1

Duhet të përmbajë: 392 kkal (prot. 0g, lipide 0g, glucide 100g)

Përdorimi: Pas interveneteve kirurgjikale në abdomen dhe në sindromën akute.

Kuota fin. ditore: 209 lekë

DIETA HIDRIKE B-2

Përdorimi: Pas interveneteve kirurgjikale në abdomen dhe në sindromën akute.

Kuota fin. ditore: 9 lekë

DIETA NË SËMUNDJET INFEKTIVE

Duhet të përmbajë: 2500 kkal (prot. 80g, lipide 60g, glucide 436g)

Përdorimi: Në hepatitet virale, salmoneloz, enterokolite të vërtetuara, bruceloz etj.

Kuota fin. ditore: 194 lekë

DIETA E LËNGËT

Duhet të përmbajë: 2100 kkal (prot. 70g, lipide 95.3 g, glucid 248.6 g)

Përdorimi: Në pacientët që operohen nga patologji që nuk inkretojnë aparatit tretës, në ushqyerjet me sondë dhe sëmundjet infektive të rënda (Shënim: Ushqimet e forta Homogjenizohen duke i përpunuar)

Kuota fin. ditore: 132 lekë

DIETA PA GLUTEN

Duhet të përmbajë: 2800 kkal (prot. 100g, lipide 78.5g, glucide 362 g)

Përdorimi: Në sindromën e keqthithjes në steatozë
Kuota fin. ditore: 106 lekë

DIETA DIABETIKE

Kjo dietë varion nga 800–3000 kkal, diapazon që përfshin diabetikët obezë dhe ata të dobët.

DIET PËR DIABETIKËT ME DIABET TË EKUILIBRUAR

Duhet të përmbajë: 2200 kkal (prot. 90 g, lipide 64 g, glucide 336g)

Përdorimi: Në sëmundjet e aparatit kardiovaskular dhe urinar në fazën e kompesimit, në sëmundjet e mëlçisë, pankreasit e surenaleve. Përdorimi i kripës nuk duhet lënë i lirë kur nisin shenjat e dekompozimit. Kur azotemia e kreatinemia sikur produkte si mishi, qumështi, dhe nënproduktet e tij ndërpriten në dietë, shtohen frutat deri në 155gr. në vend të mishit, gjizës, qumështit.

Kuota fin. ditore: 158 lekë

DIETA HIPERKALORIKE, HIPERPROTEINIKE E PASUR ME CA E FE

Duhet të përmbajë: 3000 kkal (prot. 122g, lipide 108 g, glucide 385 g)

Përdorimi: Në anemi, kaheksi, TBC, sëmundje malinje, ortopedi, plastikë, reabilitim, sëmundje psikike.

Kuota fin. ditore: 257 lekë

Shënim: Këto norma zbatohen në qendrat spitalore civile me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 28 datë 9.2.1998.

V E N D I M **Nr. 352, datë 28.7.1999**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 204, 26.3.1998 “PËR KOMPETENCAT, DETYRAT FUNKSIONALE DHE FINANCIMIN E PUSHTETIT LOKAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 204, datë 26.3.1998, bëhen këto ndryshime:

a) Në aneksin 1, pika I/3, shkronja “b) ambulancat dhe klinikat e shërbimit ambulator” zëvendësohet me shkronjën “b) qendra shëndetësore dhe ambulancat e fshatrave”.

b) Në aneksin 2 lidhja I pika 2, hiqet paragrafi i parë “investimet dhe administrimi i rrjetit ujitës në rastet kur burimet ujore brenda/afër fshatrave/qyteteve të komunës/ bashkisë dhe rrjeti i shërben vetëm një komunë ose bashkie”. Hiqet paragrafi i katërt “Ndërtimi, mirëmbajtja dhe administrimi i kanaleve kulluese dhe ujitëse të treta, në rastet kur rrjeti i tyre është ndarë nga sistemi në shkallë rrethi dhe është brenda territorit të komunës.”

c) Në aneksin 2 lidhja II pika 5 “Bujqësia” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M **Nr. 354, datë 28.7.1999**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR. 520, DATË 21.8.1998 “PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË
KOMISIONIT TË PËRBASHKËT ITALO-SHQIPTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në procesverbalin e Komisionit të Përbashkët Italo-Shqiptar, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 520, datë 21.8.1998, të bëhen rialokimet dhe shtesat, sipas pasqyrës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e shumës shtesë, prej 20 (njëzet) miliardë lirash italiane, në formën e kredisë së butë, në procesverbalin e komisionit të përbashkët italo-shqiptar, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 520, datë 21.8.1998, duke krijuar një paketë prej 42 (dyzet e dy) miliardë lirash italiane, për blerje mallrash e pajisjesh, në kuadrin e programit “Commodity Aid”.

3. Ngarkohen Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të programojnë përdorimin e paketës prej 42 (dyzet e dy) miliardë lirash italiane, në përputhje me nevojat emergjente të sektorëve parësorë. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e programit “Commodity Aid”, prej 42 (dyzet e dy) miliardë lirash italiane.

4. Komponenti B.7, në pasqyrën që i bashkëlidhet vendimit, prej 27 (njëzet e shtatë) miliardë lirash italiane të përdoret për zgjerimin e projekteve ekzistuese në sektorët e furnizimit me energji, ujë dhe, në rast nevojë, edhe për shërbime parësore në bashki.

5. Ngarkohet Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë të identifikojë, së bashku me palën italiane, mundësinë për rialokime të tjera, të mundshme nga paketa e bashkëpunimit, me synimin për t’i përdorur në kohë e me efektivitet këto burime financiare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Pandeli Majko**

Artikullimi i programit

A) Ndërhyrje në formë dhurate:	miliardë lira
1. Periferia urbane e Tiranës – Organizimi i komuniteteve	1.5
2. Ristrukturimi i strukturave shkollore	6
3. Programi në sektorin e mjedisit	1
4. Community Works	4
5. Programi i privatizimeve	2
6. Rimëkëmbja e shërbimeve kryesore bashkiake (Tiranë-Vlorë)	7.1
7. Njësitë e mbështetjes teknike Qeverisë Shqiptare	5.4
8. Regjistrimi i popullsisë	2
9. Programi në sektorin shoqëror dhe të punës	2
10. Krijimi dhe mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	1
TOTAL	32

* Shtesa prej 2 miliardë lira (kundrejt 30 miliardë që ishte më parë) sigurohet nga rialokimi i sa ishte parashikuar për asistencë teknike për SME-të në procesverbalin e kooperacionit të viteve 1992-1996.

B) Ndërhyrje si kredi ndihme miliardë
lira

1. Sektori rrugor: Rruga Rogozhinë-Vlorë (aksi Lushnjë-Fier)	30
2. Rehabilitimi i rrjetit elektrik të Tiranës, Faza e III-të dhe Asistencë teknike në menaxhimin e KESHit për përmirësimin e Administrimit të saj financiar dhe të investimeve përkatëse	28
3. Linja krediti për ndërmarrje të vogla e të mesme (industri dhe bujqësi)	5
4. Sistemi spitalor i Tiranës	10
5. Periferia e Tiranës: Komponentë infrastrukturor	6
6. Sektori ujqor i Tiranës dhe asistencë teknike për menaxhimin dhe përmirësimin e administrimit të saj financiar dhe të investimeve përkatëse	60
7. Shtesë për projektet ekzistuese	27
8. Commodity Aid	42
TOTAL	208

** Shtesa prej 28 miliardë lira (kundrejt 180 mld lira që ishte më parë) sigurohet nga riallokimi i 8 mld lira që ishin parashikuar për linja kredie për SME-të në procesverbalin e kooperacionit të viteve 1992 – 1996, si dhe një angazhim i ri për 20 mld lira për ndihmë në mallra në mallra (Commodity Aid).

V E N D I M

Nr. 355, datë 28.7.1999

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “SHQIPËRIA 2000” PËR REHABILITIMIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe në kuadrin e kredisë së dhënë nga Qeveria Greke, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e projektit “Shqipëria 2000” për rehabilitimin e institucioneve arsimore.
 2. Nga 1 500 000 000 (një miliard e pesëqind milionë) dhrahmi, të dhëna nga kredia greke për infrastrukturën sociale, shumë ekuivalente me 3 000 000 (tri milionë) USD, sipas kursit të ditës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të përdoret për realizimin e projektit “Shqipëria 2000”.
 3. Fondi i projektit “Shqipëria 2000” të realizohet nga bashkimi i fondeve 3 000 000 (tri milionë) USD, dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dhe 3 000 000 (tri milionë) USD, dhënë nga fondacioni “Soros” “Projekti për zhvillimin e arsimit në Shqipëri (AEDP)”.
 4. Projekti “Shqipëria 2000”, për rehabilitimin e institucioneve arsimore do të zbatohet nga fondacioni “Soros” dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me modalitetet e miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 226, datë 11.4.1997, “Tirana 2000”.
 5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Ministria e Financave të kryejnë procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

PROJECT SEGMENTAL / SEGMENTIMI I PROJEKTIT

1. GEOGRAPHICAL DISTRIBUTION / SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

District No. Nr. Rrethit	District Rrethi	School units Shkolla	Project no. Nr. i Projektit	Budget Buxheti (USD)
I	SHKODËR	1		320,000
II	DIBËR	1		200,000
III	DURRËS	1		440,000
IV	VLORE	1		620,000
V	SARANDË	1		630,000
VI	KORÇË	1		265,000
VII	MIRDITË	1		65,000
VIII	TEPELENË	2		170,000
IX	GJIROKASTËR	1		430,000
X	DELVINË	1		180,000
XI	TIRANË	1		620,000
XII	BASHKIA TIRANË	10		2,060,000
		22		6,000,000

V E N D I M
Nr. 358, datë 28.7.1999

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE
TË DOGANAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Për punonjësit e doganave, skema e strukturës së pagës është sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Struktura e pagës mujore përbëhet:

1. Paga e grupit sipas nivelit arsimor të kërkuar nga vendi i punës:

- Paga e grupit I “1” Diplomë e shkollës së lartë
- Paga e grupit II “2” Diplomë mbi shkollën e mesme
- Paga e grupit III “3” Diplomë e shkollës së mesme
- Paga e grupit IV “4” Dëftesë lirimi (arsimi 8-vjeçar)

Diploma mbi shkollën e mesme konsiderohen të gjitha diplomat e kurseve me program mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në legjislacionin në fuqi. Në këtë grup përfshihen, gjithashtu, të gjithë ata të cilët kanë mbaruar 2 vite akademike të shkollës së lartë.

Pagat për çdo grup pune janë sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shtesa për vjetërsi në punë, në profil, jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

3. Shtesë kualifikimi. Kjo shtesë jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit në përqindje, si vijon:

- Në masën 5 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së tretë.
- Në masën 10 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së dytë.
- Në masën 20 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së parë.

Në rastin e punonjësve të doganave kjo kolonë është bosh dhe do të plotësohet me përcaktimin e standardeve dhe niveleve të kualifikimit, në një të ardhme.

4. Shtesa e pozicionit është përcaktuar për çdo vend pune sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Shtesa për kushte pune është përcaktuar për çdo vend pune sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Deri në fund të vitit 1999, doganierët pa arsim përkatës, të zëvendësohen me punonjës me arsim të lartë, sipas kërkesave të Kodit Doganor.

IV. Ngarkohet Ministria e Financave që, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatimin e këtij vendimi.

V. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 437, datë 3.9.1993 “Për pagat e punonjësve të tatimeve dhe doganave” për pjesën e punonjësve të doganave shfuqizohet.

VI. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Lidhja nr.1

STRUKTURA E PAGËS SË DOGANAVE

(Paga fakt)

K A T E G O R	EMËRTIMI	PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E PROFESIONIT		T O T A L I
I K A T	EMËRTIMI	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion	Shtesa për kushte pune	T O T A L
E G		(PG)	(SHV)	(SHK)	(SHP) lekë	(SHKP) lekë	L I
O R A A	Drejtor drejtorie në departament Drejtor drejtorie rajonal	1	2% për çdo vit pune		22490	14060	Nga..Lek Deri..Lek
B	Përgjegjës sektori Kryetar dege	1	“		17824	12446	Nga..Lek Deri..Lek

	Inspektor						
1	Specialist, hetues doganë, Drejtues turni	1	“		11248	11732	Nga..Lek Deri..Lek
2	Doganier	1	“		8861	9949	Nga..LekDeri..Lek
2	Doganier	3	“		8861	9949	Nga..Lek Deri..Lek
1	Doganier, shofer, regjistruer, sekretare Magaziniere, operator, laborant	3	“		7226	7974	Nga..Lek Deri..Lek
2	Centraliste Sportelist	3	“		7226	7974	Nga..LekDeri..Lek
	Sanitare Punëtor mirëmbajtje	4	“		4150	1545	Nga..Lek Deri..Lek

Lidhja nr. 2

GRUPI	PAGA NË LEKË
1	6000
2	5000
3	4500
4	3000

V E N D I M
Nr. 362 datë 4.8.1999

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË SIGURIMIT, TË
BASHKËRENDIMIT DHE TË GRUPIT TË GATSHËM TË POLICISË,
PËR ASETET E SHOQËRIVE HUAMARRËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë apo bankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të ngrihet dhe të funksionojë, deri në përfundim të procesit të transparencës, shërbimi i sigurimit, i bashkërendimit dhe grupi i gatshëm i policisë, për problemet e ruajtjes, zbulimit dhe rikthimit, pranë administratorëve të shoqërive huamarrëse, të aseteve të grabitura nga persona të tretë, fizikë apo juridikë.

2. Shërbimi i sigurimit dhe i bashkërendimit përbëhet nga dy specialistë, oficerë të Ministrisë së Rendit Publik dhe nga një grup i gatshëm policie. Detyrat funksionale dhe kompetencat e tyre përcaktohen me urdhër të veçantë të Drejtorisë së Policisë, pranë Ministrisë së Rendit Publik.

3. Shërbimit të sigurimit dhe të bashkërendimit i vihen në dispozicion një autoveturë policie, ndërsa grupit të gatshëm të policisë një furgon, të cilat sigurojnë lidhje të vazhdueshme me administratorët dhe drejtoritë e policisë në prefektura.

4. Specialistët e shërbimit të sigurimit dhe të bashkërendimit, për vështirësitë e punës që kryejnë, trajtohen me shtesë në pagë për vështirësi në punë, me urdhër të veçantë të Ministrit të Rendit Publik. Numri i specialistëve të shërbimit të sigurimit dhe të bashkërendimit dhe të grupit të gatshëm të policisë, si dhe fondi i pagave të tyre, përballohen nga buxheti i vitit 1999, i miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 380, datë 12.8.1999

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT
TË MINISTRAVE NR. 32, DATË 25.1.1999 “PËR DHËNIEN NË
ENFITEOZË TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇELIKUT ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8333, datë 23.4.1998 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 32, datë 25. 1. 1999 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 të ndryshohet si vijon:

“Përfashtimisht nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 9.7.1998 “Për dhënie me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive apo institucioneve shtetërore”, të ardhurat nga shpërblimi periodik mujor i kësaj kontrate të përdoren tërësisht (100 për qind), për një periudhë dy vjeçare, për trajtimin financiar të punonjësve që dalin të papunë nga lidhja e kësaj kontrate”.

2. Pas pikës 2 të shtohet pika 2/1 si vijon:

“Pas dy viteve të para, të ardhurat e kësaj kontrate do t’i nënshtrohen kritereve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 9.7.1998 “Për dhënie me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive apo institucioneve shtetërore””.

3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 384, datë 28.7.1999

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT “PËR DISA MASA PËR FUQIZIMIN E RENDIT DHE TË SIGURISË PUBLIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të miratojë programin “Për disa masa për fuqizimin e rendit dhe të sigurisë publike”.
 2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij programi.
 3. Efektet financiare dhe numri i punonjësve janë ato të miratuara në buxhetin e Ministrisë së Rendit Publik për vitin 1999.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

P R O G R A M

MBI DISA MASA PËR FUQIZIMIN E RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE

Nisur nga:

- Faktorët që ndikojnë në rritjen e kriminalitetit si gjendja e rëndë ekonomike, papunësia masive, emigrimi i paligjshëm, inefficenca e organeve ekzekutive dhe atyre të mbrojtjes së ligjit, etj.,
- Problemet e krijuara nga menaxhimi i krizës humanitare me të dëbuarit nga Kosova,
- Gjendja e rendit dhe kriminalitetit, i cili në disa zëra ka rritje, sidomos në krimet kundër jetës së personit, aktet terroriste, vjedhjet me dhunë dhe në krimin e organizuar,
- Programi i Qeverisë, i cili përcakton rendin dhe sigurimin publik si “detyrë parësore të qeverisjes në kushtet aktuale”, programi “Për reformën institucionale në administratën publike e shërbimin civil”, si dhe Programi i Ministrisë së Rendit për vitin 1999,
- Legjislacioni ekzistues i shtetit dhe detyrimet që dalin nga miratimi i Kushtetutës së Re të Republikës së Shqipërisë,
- Gjendja e efektivave të policisë, të cilat mbartin në vetvete rezerva e mundësi më të mëdha për përballimin e detyrave të ngarkuara në mbrojtje të rendit e ligjit,
- Pasiguria dhe interesimi i madh që ekziston në shoqërinë shqiptare për rivendosjen e rendit dhe të sigurisë publike,
- Rekomandimet e ndihma e gjithanshme që japin organizmat ndërkombëtare e veçanërisht ato të Këshillit të Europës,

Me synimin:

Të fuqizojmë rendin e sigurinë publike, garantojmë liritë dhe të drejtat e qytetarëve dhe institucionalizojmë mbi baza të reja ligjore strukturat dhe veprimtarinë e shërbimit policor.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë programon objektivat dhe masat e mëposhtme:

NË KUADRIN E MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK

1. Të institucionalizohet veprimtaria e Ministrisë dhe organeve policore mbi bazën e ligjeve, akteve nënligjore dhe planifikimit të punës në të gjithë strukturat përbërëse.

Për këtë:

- Të përgatiten e miratohen ndryshimet përkatëse në legjislacionin penal, atë procedural, si dhe ligje e vendime të veçanta që rregullojnë veprimtarinë policore, duke bashkëpunuar me ministrinë përkatëse.

Gjatë 6-mujorit të dytë 1999

- Të përgatiten akte nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e brendshme të sektorëve e shërbimeve policore.

Gusht-Tetor 1999

- Të ndërtohet gjithë veprimtaria policore mbi bazen e programeve e planeve dhe të ndiqet me përparësi realizimi i detyrave nga çdo hallkë, duke forcuar kontrollin me të gjitha format e punës.

E vazhdueshme

- Të konsolidohet funksionimi i strukturave policore për kontrollin e teritorit, atyre të goditjes dhe Policisë Kriminale për zbulimin e goditjen e kriminalitetit.

E vazhdueshme

- Të ngrihet strukturë e posaçme për grumbullimin e armëve në bazë të legjislacionit të miratuar dhe ndiqet në vazhdimësi realizimi i detyrës.

E vazhdueshme

2. Të kualifikohet, përzgjidhet dhe krijohen kushtet e nevojshme personelit të policisë për motivimin në punë.

Për këtë:

- Të intensifikohet kualifikimi i personelit të Policisë në bashkëpunimin me misionin MAPE, e organizmat e tjera, duke ndërtuar programe të përsheptuara sipas strukturave e shërbimeve policore.

E vazhdueshme

- Mbi bazën e programeve të veçanta, të organizohet testimi profesional dhe vlerësimi për të gjithë punonjësit e Policisë nën drejtimin e aparatit qendror të Ministrisë së Rendit.

Gusht 1999

- Të përcaktohen qartë kriteret profesionale dhe funksionojnë komisionet e emërimeve e ato të masave disiplinore në Ministri e organet policore të bazës, për të përgatitur kandidaturat dhe gjykuar ankesat e punonjësve.

E vazhdueshme

- Të ndiqet me përparësi: - Krijimi i kushteve të punës për organet Policore. Për këtë të përfundojnë ndërtimi i godinave të organeve policore në Shkodër, Sarandë, Përmet; rikonstruksioni i dhomave të paraburgimit dhe postave kufitare, si dhe rregullimi i disa mjediseve në Ministri.

- Pajisje me teknikën policore më emergjente për vetmbrojtje e luftimin e krimit.

- Kompjuterizimi në vendkalimet kufitare dhe në kartotekat e organeve policore.

- Veshje e strukturave të Policisë me uniformë përkatëse.

- Kompletimi në masën 70%, të nevojave me mjete transporti dhe ndërlidhje.

Gusht 1999 – Vazhdim

- Të zbatohen dispozitat e ligjit “Për statusin e ushtarakut” dhe vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave:

- a) “për trajtimin me ushqim falas (një vakt) të Policisë;

- b) për lehtësimin për strehim të punonjësve të Policisë me dhënie kredie afatgjatë.

3. Të organizohen shërbimet policore (parandaluese, zbuluese e goditëse). Për zotërimin e rendit në rrugë, qytete, zona kufitare, kampingje, grumbullimin e armëve të shpërndara në popull, dhe zbulimin e goditjen e krimit. Përparësi për realizimin e këtij objekti t’i jepet:

- kontrollit të rrugëve ku kryhen vrasje, grabitje e vjedhje me dhunë;

- kontrollit të territorit në qytete ku kryhen akte kriminale;

- kontrollit të kufirit në zonën veri-lindore, në vend kalimet kufitare dhe atë të bregdetit për parandalimin e trafikeve të kundërligjshme;

- mbledhjes së armëve që administron popullata;

- zbulimit dhe goditjes të krimeve të rënda, veçanërisht vrasjeve, akteve terroriste, rëmbimeve dhe krimin të organizuar.

Për këtë:

- Të grupohen forcat policore, ribëhen planet dislokuese dhe organizohen shërbime patrulluese e kontrolluese në rrugë, qytete, kufi etj.

- Të merren në ruajtje objekte të rëndësishme nga polici të tjera, shërbimet e ruajtjes private dhe çlirohen forcat policore të rendit për të shërbyer në mbrojtje të rendit e qytetarëve.

- Në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor e ato të ushtrisë me plane të veçantë të realizohet mbrojtja e kufirit dhe sigurimi i rendit publik.

- Në bashkëpunim me strukturat e tjera, me plane të veçanta në zbatim të legjislacionit të ruhet kufiri bregdetar dhe ndalohet trafiku klandestin e veprimtaritë e tjera të kundërligjshme.

Shërbimi i policisë kufitare të mbështetet me mjetet e nevojshme si motoskaft, anije, gomone etj., të kapura nga veprimtaritë e kundërligjshme.

- Të miratohet projektvendimi përkatës, i paraqitur në Këshillin e Ministrave për çeljen e organikës, fondit financiar dhe sigurimin e mjeteve. Mbi këtë bazë të fillojnë nga puna strukturat për grumbullimin e armëve, duke u angazhuar të gjitha institucionet që kanë detyrimet ligjore.

- Të bëhet forcimi i strukturave të policisë kriminale, duke bërë ndryshimet e duhura në organizim, krijimin e grupeve të veçanta për ndjekjen e krimeve të rënda në princip drejtimi, si dhe duke forcuar bashkëpunimin me organet e prokurorisë.

- Për rritjen e treguesve në dokumentimin e veprimtarisë kriminale të kompletohet organika, përzgjidhet personeli nëpërmjet testimit, dhe rritet cilësia e veprimeve procedurale ndërsa për sigurimin e informacionit të intensifikohet puna operative e ajo shpërblyese dhe rritet shpejtësia e veprimeve me mjetet e teknikën e duhur.

- Për autorët e krimeve në kërkim të organizohet puna gjurmuese dhe bashkëpunimi me Interpolin e vendet fqinje nëpërmjet kompletimit të infrastrukturës institucionale dhe rritjes së shpejtësisë së veprimeve.

- Për goditjen e kontrabandës e trafikeve të tjera, të forcohet bashkëpunimi institucional dhe përqëndrohet veprimtaria në rrjetin e organizuar kriminal.

4. Të përgatitet “Programi për reformën në Polici” dhe infrastruktura e re ligjore e organizative e saj.

Synimi është që:

- Të reformohet në formë e përmbajtje Policia e Shtetit. Për këtë të përgatitet një program i qartë me strategji, objektiva, rrugë, afate kohore, faturë ekonomike etj.

- Policia të shndërohet përfundimisht në një shërbim publik me status të veçantë, konform parimeve të policimit perëndimor.

- Të ndahet qartë niveli politik nga ai policor në Ministrinë e Rendit.

- Të përcaktohet mirë misioni i Policisë, detyrat institucionale, të drejtat e saj në kushte normale e situata krizash apo të jashtëzakonshme.

- Të ndërtohet një strukturë policore unike, dinamike e operative, pa hallka burokratike, në shërbim të qytetarëve dhe institucioneve demokratike.

- Të institucionalizohet tërë veprimtaria policore, bashkëpunimi me organet e tjera shtetërore dhe ato homologe jashtë vendit.

- Të reformohet tërë sistemi arsimor e kualifikues i Policisë, si dhe trajtimi i saj ligjor e motivues.

- Të fuqizohen marrdhëniet me publikun duke e siguruar atë dhe realizuar mbështetjen prej tij.

Për këtë:

Të punohet me grup pune të veçantë mbi bazën e një programi për përgatitjen e :

a) programit “Për reformën në Polici”;

b) ligjit “Për Policinë e shtetit Shqiptar”;

c) ligjit “Për gradat në Polici” dhe vendimit përkatës;

ç) ligjit “Për shpërblimet suplementare e pensionet në Polici” dhe vendimit përkatës;

d) rregullores së brendshme të Policisë;

dh) rregullores së disiplinës në Polici;

e) rregullores së Personelit;

f) strukturës së re organizative të Policisë në qendër e bazë, dhe akte të tjera ligjore e

nënligjore.

Projektet do të paraqiten pas miratimit të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

MASAT NË NIVEL NDËRMINISTROR

KËSHILLI I MINISTRAVE

Të krijohet me vendim të veçantë Komiteti Kombëtar Ndërmministrat për problemet e rendit dhe sigurisë publike:

në nivel qendror;

në nivel prefekturë.

Shtator 1999

Të miratohet një ndryshim ligji nr. 8388, datë 5.8.1998 “Për grumbullimin e armëve dhe municioneve luftarake: (duke shtyrë edhe një vit vlefshmërinë e tij).

- Të miratohet projektvendimi për krijimin e Sektorit të policisë së rendit për grumbullimin e armëve.

- Të miratohet rregullorja e punës së Komisionit Qendror për Grumbullimin e Armëve.

Shtator 1999

Të analizojë shkaqet e ineffiçencës së organeve të ndryshme policore e të inspeksioneve; kompletimin ligjor për bashkëpunimin institucional dhe të shtojë kontrollin e sanksionit ndaj nëpunësve të mbrojtjes së ligjit.

Shtator 1999

Të hartohen dhe miratohen aktet normative për veprimet e organeve shtetërore në rast krizash e ngjarjesh të jashtëzakonshme, në zbatim të strategjisë për politikën e sigurimit.

Shtator – Gusht 1999

Në bazë e për zbatimin e ligjit nr. 7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut”:

- Të miratohet vendimi për trajtimin e bashkëshorteve të ushtarakëve, të cilat janë të papuna, me banim në qytet dhe nuk kanë pronë;

- Të miratohet vendimi për trajtimin me kredi për strehim për punonjësit e policisë;

- Të miratohet vendimi për aplikimin në kufijt maksimalë të vështirësisë së shërbimit për ushtarakët 80% dhe për civilët 50%;

- Të miratohen dispozitat për disa ndryshime në ligjin “Për sistemin e taksave dhe tatimeve”, duke parashikuar zbritjen e tatimit mbi të ardhurat personale në masën 50% të asaj që aplikohet sot, për punonjësin e policisë.

Gusht – Shtator 1999

Fondet nga të ardhurat e Ministrisë së Rendit Publik të përdoren për:

- rikonstruksionin e disa godinave të komisariateve të policisë, dhomave të paraburgimit dhe pikave të kufirit për 76 milionë lekë;

- kompletimin e pikave të kufirit dhe të komisariateve të policisë në rrethe me pajisje e orendi për rreth 75 milionë lekë;

- vendosjen e sistemit të radiokomunikimit të forcave speciale, për forcat e ndërhyrjes së shpejtë, grupin e shoqërimit të personaliteteve, Drejtorinë e Tiranës dhe Ministrinë, si dhe ngritja e sistemit të alarmit të Ministrisë së Rendit Publik, për rreth 98 milionë lekë;

- kompletimin e nevojave organike të sistemit të ministrisë me automjete, prej të cilave 30 autovetura, 50 motoçikleta, 30 mikrobuze, 5 autoambulanca, 10 automjete të blinduara.

Shtator 1999

Të rekomandojë ndryshimet përkatëse në vendimet që rregullojnë pjesëmarrjen e institucionit (ministrisë) në të ardhurat që ajo krijon nga shërbimet me të tretët, konkretisht:

- të ardhurat me destinacion, si të ardhurat nga aktiviteti i policisë me kontratë, të ardhurat nga shitja e vulave, të ardhurat nga shitja e targave, të cilat me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 424,

datë 9.7.1998 janë përcaktuar 10% buxheti dhe 90% institucioni, për këto të ardhura pjesëmarrja e institucionit të jetë në masën 100%;

- të ardhurat me pjesëmarrje si, të ardhurat nga shitja e letrave me vlerë, të ardhurat nga MNZ-ja, të cilat me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 424, datë 9.7.1998 janë me pjesëmarrje 60% institucioni dhe 40% për buxhetin, për këto të ardhura të parashikohet pjesëmarrja e institucionit 80% dhe për buxhetin 20%;

- të ardhurat pa pjesëmarrje, si të ardhurat nga shitja e pasaportave nga 10% që është pjesëmarrja sot të ndryshohet e të bëhet 20%.

Shtator –Tetor 1999

MINISTRIA E FINANCAVE

Të bëjë studimet e duhura dhe t'i paraqesë Këshillit të Ministrave mundësitë e sigurimit të fondeve për zbatimin e këtij programi.

Sipas afateve në program

Të përfundojë dhe të paraqesë për miratim aktet nënligjore, në zbatim të Kodit të Ri Doganor, si dhe të ligjit “Për Policinë Kufitare”, në lidhje me kompetencat dhe procedurat e punës në pikat e kalimit kufitar për parandalimin e fenomeneve të kontrabandës e të trafikeve të kundraligjshme.

Në bashkëpunim me M.R.P

Gusht 1999

Të rishikojë ligjin “Për sponsorizimet”, me synim njohjen e të drejtës së sponsorizimeve për aktivitetin policor në shërbim të publikut, si dhe konsulencë në hartimin e akteve nënligjore në zbatim të tij.

Gusht – Shtator 1999

Të kalojë fondet institucioneve respektive për ruajtjen e objekteve me kontratë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 18.10.1998.

Në bashkëpunim me M.R.P

Gusht 1999

Të hartojë aktet normative për përjashtimin nga detyrimet doganore të ndihmave në adresë të policisë.

Shtator 1999

Të analizojë dhe të marrë masa konkrete për të vënë në efikasitet të plotë strukturat e policisë tatimore e doganore.

Shtator 1999

Të kryejë transferimet e fondeve sipas kërkesave të paraqitura nga MRP më shumë se një herë në dy muaj, kufizim ky i përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 1 datë 20.01.1999.

Të miratojë avancimin e fondeve brenda planit të shpenzimeve buxhetore, në raport me nevojat e Ministrisë së Rendit Publik.

Në bazë të kërkesave të paraqitura nga Ministria e Rendit Publik për konvertim të fondeve buxhetore në valutë, të miratojë në kohë autorizimin përkatës.

Të përshpejtojë punën për dhënien në kohë të autorizimit për përdorimin e të ardhurave që i takojnë Ministrisë së Rendit Publik.

MINISTRIA E PUSHTETIT LOKAL

Të organizojë prefekturat dhe organet e pushtetit vendor për pjesëmarrjen në procesin e grumbullimit të armëve dhe zgjidhjen e problemeve të vetëgjyqësisë e gjakmarrjes.

Gusht– Shtator 1999

Përfundimi i rregullimit ligjor për regjistrimin popullsisë, me synim aplikimin e kartave të

identitetit për shtetasit shqiptar.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë

Nëntor 1999

Sigurimi i fondeve dhe/ose kërkesa ndaj organeve të pushtetit lokal për marrjen e masave urgjente për ndriçimin qendrave të banuara.

Tetor - Nëntor 1999

MINISTRIA E DREJTËSISË

Rishikimi i Kodit Penal dhe të Procedurës Penale, nën këndvështrimin e Kushtetutës së re dhe të procesit reformues në policinë e shtetit.

Në bashkëpunim me M.R.P

Tetor 1999

Riorganizimi i shërbimit të ruajtjes dhe shoqërimit të të paraburgosurve, me synim kalimin e këtij shërbimi nga policia e rendit në policinë penitenciare.

Në bashkëpunim me M.R.P.

Gusht 1999

Të përfundojë dhe të paraqesë për miratim projektligjin për policinë gjyqsore.

MINISTRIA E MBROJTJES

Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për grumbullimin e armëve”, për procedurat e bashkëpunimit me strukturat policore, si dhe vënia në dispozicion për këtë qëllim e 15 automjeteve. (Në varësi të ndryshimeve në ligjin përkatës).

Në bashkëpunim me MRP

Nëntor 1999

Hartimi i udhëzuesve të përbashkët për ndihmën e Forcave të Flotës Detare në parandalimin e fenomeneve të trafikut të klandestinëve nëpërmjet ujërave detare.

Në bashkëpunim me MRP

Shtator 1999

Të ndihmojë MRP në drejtim të kompletimit me armatim e municion, konkretisht, pistoletë model 54, pjesë këmbimi për riparim armatimi, 3 mjete të blinduara me goma, etj.

Korrik 1999

Të përshpejtojë procedurat për kalimin kapital të ndërtesave që i vihen në dispozicion të Ministrisë së Rendit Publik.

Shtator 1999

SHËRBIMI INFORMATIV KOMBËTAR

Të marrin masa për institucionalizimin e bashkëpunimit me policinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit Publik, nëpërmjet përgatitjes së akteve normative për këtë qëllim.

Shtator 1999

MINISTRIA E PUNËS DHE PËRKRAHJES SOCIALE

Realizimi i programeve të punësimit, për zbutjen e fenomenit të papunësisë, i cili ndikon në gjendjen e kriminalitetit.

Studimi i mundësive optimale për sistemin e pagave për punonjësit e policisë, me synim motivimin për arritjen e rezultateve të larta në luftën kundër krimit.

Në bashkëpunim me MRP

Shtator 1999

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Të ndërmarrë nisma të fuqishme për lehtësimin e sistemit të vizave, kryesisht me shtetet fqinje, si masë për parandalimin e fenomenit të lëvizjes klandestine nga kufijtë e R.Sh.

Nëpërmjet kontakteve e rrugëve diplomatike të garantohet kredibiliteti i vlefshmërisë së pasaportës shqiptare.

- Të likuideojë detyrimet financiare ndaj MRP-së për të ardhurat nga shitja e pasaportave në përfaqësitë diplomatike.

Shtator 1999

MINISTRIA E BASHKËPUNIMIT EKONOMIK E TREGTISË

Të miratojë në kohë transferimin e fondeve sipas zërave të investimeve, brenda planit vjetor të investimeve.

Nxitja për programin PHARE dhe PMU për Ministrinë e Rendit Publik.

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE E TRANSPORTIT

Të përgatisë aktet nënligjore në zbatim të Kodit Rrugor për sa i përket problemeve të qarkullimit rrugor, gjendjes së rrugëve dhe procedurat për bashkëpunimin me policinë rrugore të MRP.

Në bashkëpunim me M.R.P

Gusht 1999

Të marrë në analizë dhe të përcaktojë masat e nevojshme për vënien në efikasitet të plotë të Policisë Ndërtimore në shkallë vendi, si një element i rëndësishëm që ndikon për garantimin e rendit publik.

Gusht 1999

V E N D I M **Nr. 392, datë 12.8.1999**

PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT TË VEÇANTË MONETAR, TË KRIJUAR SIPAS LIGJIT NR. 7598, DATË 1.9.1992 “PËR ISH-TË DËNUARIT DHE ISH-TË PËRNDJEKURIT POLITIKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 5 të ligjit nr. 8246, datë 1.10.1997 “Për Institutin e Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Për plotësimin e kërkesave me karakter emergjent të ish-të dënuarve dhe ish-të përndjekurve politikë, fondi i veçantë monetar, i krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 1.9.1992, të administrohet nga Instituti i Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë, sipas kriterëve të mëposhtme:

a) 50 për qind e këtij fondi për të ndihmuar, ekonomikisht e materialisht, familjet e përndjekura, për nevoja urgjente, për integrimin e tyre shoqëror;

b) 50 për qind për të financuar shoqatat e ish-të përndjekurve politikë. Financimi i shoqatave të veçanta do të bëhet në përpjestim me numrin e anëtarëve të tyre.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 26.10.1993 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 404, datë 26.8.1999

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 78, DATË 21.1.1999
“PËR RUAJTJEN E PRONËSISË SHTETËRORE NË DISA SHOQËRI TREGTARE DHE
NDËRMARRJE”

Në bazë të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 21.1.1999, në pikën 1, në fund të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, shtohen këto emëresa:

Emri i ndërmarrjes	Vendndodhja	Varësia	Statusi	Përqindja e pjesëmarrjes shtetërore në kapital
“PETROLIMPEX”	Tiranë	Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	Shoqëri anonime	51 për qind
“BUKA”	Tiranë	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	Shoqëri anonime	51 për qind

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 407, datë 31.8.1999

PËR PRIVATIZIMIN ME ANKAND PA ÇMIM FILLESTAR TË PAKETAVE
SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË DISA SHOQËRIVE TREGTARE

Në mbështetje të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ligjit nr. 8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Privatizimin nëpërmjet shitjes me ankand pa çmim fillestar të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare si vijon:

- Arteksportimport, sh.a. Tiranë	51%
- Alimpeks, sh.a. Tiranë	51%
- Frigoriferi, sh.a. Durrës	51%
- Prodhime material ndërtimi, sh.a. Elbasan	51%
- Mekanika i industrisë ushqimore, sh.a. Elbasan	51%
- Dinamo, sh.a. Tiranë	51%
- Përpunim pesticide, sh.a. Durrës	51%
- Mobilje sh.a. Durrës	51%
- Agroeksport sh.a. Tiranë	51%
- NFN nr. 1, sh.a. Durrës	51%
- NFN nr. 2, sh.a. Durrës	51%
- Kaldaja, sh.a. Durrës	51%
- Industrialimpeks, sh.a. Tiranë	51%
- Uzina mekanike pjesë ndërimi, sh.a. Durrës	51%
- NGP Drithi, sh.a. Korçë	20%
- NF Komunikacion, sh.a. Durrës	20%
- Tekstile, sh.a. Berat	51%
- Frigorifer Dvoran, sh.a. Korçë	30%

2. Agjencia Kombëtare e Privatizimit anulon publikimin e filluar për këto shoqëri.

3. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të nxjerrë urdhrat përkatës, në përputhje me pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 409, datë 31.8.1999

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 418,
DATË 9.7.1998 “PËR PROCEDURAT E LIKUIDIMIT TË NDËRMARRJEVE
TË FALIMENTUARA NË RRUGË ADMINISTRATIVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 48/1 të ligjit nr. 8017, datë 28.10.1995 “Për procedurat e falimentimit”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 9.7.1998 “Për procedurat e likuidimit të ndërmarrjeve të falimentuara në rrugë administrative”, në pikën 1, paragrafi i dytë, pas fjalëve “Fabrika e Letrës, Kavajë” shtohen:

- Uzina e Superfosfatit Laç, (pjesa e papërfshirë në kapitalin e sh.a., Superfosfati Kurbin)
- Fabrika e Çorapeve, Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 413, datë 3.9.1999

**PËR “HAPJEN E LLOGARISË “PËR FINANCIMIN E PROJEKTIMIT
DHE TË NDËRTIMIT TË AKSIT RRUGOR DURRËS – KUKËS – QAFË MORINË””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pranë Bankës së Kursimeve të hapet llogaria në lekë dhe në valutë “Për financimin e projektimit dhe të ndërtimit të aksit rrugor Durrës – Kukës – Qafë Morinë”, ku mund të depozitohen kontributet nga individë, shoqëri tregtare apo institucione financiare vendase ose të huaja.

Fondi që do të krijohet, do të përdoret me qëllim financimin e studimit, të projektimit dhe të ndërtimit të aksit rrugor Durrës – Kukës – Qafë Morinë.

Ngarkohet Banka e Kursimeve të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për publikimin e numrit të llogarisë si në lekë, ashtu edhe në valutë, brenda dhe jashtë vendit.

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të marrë të gjitha masat e nevojshme për hartimin e studimit dhe të projekteve të nevojshme për ndërtimin e aksit rrugor Durrës – Kukës – Qafë Morinë.

Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë të marrë masat e nevojshme për gjetjen e burimeve të huaja të financimit për studimin, projektimin dhe ndërtimin të aksit rrugor Durrës – Kukës – Qafë Morinë.

Ministria e Financave të nxjerrë udhëzimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 415, datë, 26.8.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 791, DATË
24.12.1998 “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR. 694, DATË 21.10.1996 “PËR NORMËN MËSIMORE E SHKENCORE NË SHKOLLAT E
LARTA DHE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR, PAGIMIN E ORËVE SUPLEMENTARE,
AKTIVIZIMIN E PENSIONISTËVE DHE PUNONJËSVE TË JASHTËM NË SISTEMIN E
ARSIMIT””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7810, datë 6.4.1994 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 791, datë 24.12.1998 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 694, datë 21.10.1996 “Për normën mësimore shkencore në shkollat e larta dhe në arsimin parauniversitar, pagimin e orëve suplementare, aktivizimin e pensionistëve dhe punonjësve të jashtëm në sistemin e arsimit”, pika 1 germa “b”, ndryshohet si vijon:

“b. Në shkollat e larta, sasia e orëve mësimore mbi normën e miratuar, lejohet sipas nevojave të shkollës deri në masën 45 për qind dhe, për raste të veçanta, me miratim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës lejohet jo më shumë se 70 për qind e normës. Vetëm për vitin mësimor 1997 – 1998, orët

mësimore suplementare të paguhen mbi masën 70 për qind, me miratim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës”.

2. Efektet ekonomike të përballohen nga buxheti i planifikuar për vitin 1999 për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 437, datë 9.9.1999

**PËR SHPALLJEN PROJEKT KOMBËTAR TË “STUDIMIT RAJONAL TË
ZHVILLIMIT TË HAPËSIRËS TIRANË – DURRES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen projekt kombëtar të “Studimit rajonal të zhvillimit të hapësirës Tiranë – Durrës”.
 2. Ngritjen e komisionit shtetëror, sipas listës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Komisioni të kryesohet nga Zëvendëskryeministri, i cili do të ndjekë realizimin e këtij projekti kombëtar.
 3. Ngarkohen institucionet e përmendura në listën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të bashkëpunojnë për plotësimin e këtij projekti me të dhënat, projektet e programet që ato kanë apo që duhet të hartojnë në kuadrin e këtij projekti.
 4. Ngarkohet komisioni shtetëror i këtij projekti kombëtar të rakordojë dhe të propozojë, në bashkëpunim me Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe me Ministrinë e Financave, fondin e duhur për realizimin e plotë të këtij projekti.
 5. Pranë Drejtorisë së Zhvillimit Urban, në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, të krijohet njësi e monitorimit të këtij projekti, e cila do të funksionojë për atë periudhë kohe të caktuar nga komisioni shtetëror i këtij projekti.
 6. Njësia e monitorimit të projektit do të ndihmojë në rakordimin e punës studimore e projektuese të Institutit të Studimeve dhe të Projektmeve Urbanistike dhe të institucioneve të tjera të specializuara, të përmendura në listën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe institucionet shtetërore, të listës nr.2 për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

Lista nr. 1

**KOMISIONI SHTETËROR PËR PROJEKTIN KOMBËTAR “STUDIMI RAJONAL
PËR ZHVILLIMIN E HAPËSIRËS TIRANË – DURRES”**

Zëvendëskryeministri
Ministri e Punëve Publike dhe Transportit
Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit
Ministri i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë
Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit

Kryetar
anëtar
“
“

Ministri i Financave	“
Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	“
Ministri i Pushtetit Lokal	“
Sekretari Shkencor i Akademisë së Shkencave	“
Kryetari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit	“
Drejtori i Institutit të Statistikave	“
Kryetari i Këshillit të Rrethit Tiranë	“
Kryetari i Këshillit të Rrethit Durrës	“
Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Urban në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit	“

Lista mbyllet me nr. rendor 14

Lista nr. 2

INSTITUCIONET BASHKËPUNËTORE PËR HARTIMIN E PROJEKTIT KOMBËTAR
“STUDIMI RAJONAL I ZHVILLIMIT TË HAPËSIRËS TIRANË – DURRËS”

Instituti i Studimeve e Projektmeve Urbanistike
Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellësve dhe Kanalizimeve
Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave
Instituti i Transporteve
Enti Kombëtar i Banesave
Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
Sekretaria Teknike e Ujërave
Instituti i Studimit të Tokave
Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave dhe Degët e tyre në rrethet Tiranë dhe Durrës
Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Degët e tyre në rrethet Tiranë dhe Durrës

Durrës

Drejtoritë e Bujqësisë dhe Ushqimit në Rrethet Tiranë dhe Durrës
Instituti i Sizmikës
Instituti i Hidrometeorologjisë
Qendra e Kërkimeve Gjeografike
Muzeu i Shkencave të Natyrës
Instituti i Monumeteve të Kulturës
Qendra e Kërkimeve Arkeologjike
Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës
Instituti i Statistikave
Këshilli i Rrethit Tiranë dhe Këshilli i rrethit Durrës
Telekomi Shqiptar
23. Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare
24. Ndërmarrja Hidrogeologjike
Lista mbyllet me nr. rendor 24.

V E N D I M
Nr. 438, datë 15.9.1999

PËR RRITJEN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË TEKSTEVE TË
ARSIMIT SHKOLLOR, PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7851, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Çmimet e shitjes me pakicë të librave, të arsimit parauniversitar të rriten, mesatarisht, 15-20 për qind kundrejt çmimeve të tyre me pakicë, në fuqi, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 591, datë 8.9.1998 “Për rritjen e çmimeve të teksteve të arsimit shkollor, parauniversitar”.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të llogarisë çmimet e reja të këtyre librave dhe t’i shpallë ato për zbatim, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi. Këto çmime të zbatohen për të gjithë librat shkollorë të arsimit parauniversitar, që janë në qarkullim dhe që vazhdojnë të shtypen.

Diferenca ndërmjet çmimeve të reja dhe atyre të mëparshme për sasitë që janë gjendje, pranë subjekteve shtetërore, përkatëse të shitjes me pakicë, dhe të shtypura të derdhen, detyrimisht, në Buxhetin e Shtetit.

Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës që, në bashkëpunim me organet përkatëse të pushtetit vendor, të ndjekë dhe të marrë masat e nevojshme për kryerjen e rregullt të inventarizimeve, për sistemimin e diferencave të çmimeve dhe për derdhjen e tyre në Buxhetin e Shtetit, gradualisht me shitjen me çmime të reja të librave shkollorë që janë gjendje.

Diferencat ndërmjet shpenzimeve të prodhimit e të shpërndarjes së librave shkollor të arsimit parauniversitar dhe çmimeve përkatëse me pakicë, të caktuara sipas këtij vendimi, të vazhdojnë të subvencionohen nga Buxheti i Shtetit, sipas shumës përkatëse, të miratuar në Buxhetin e Shtetit.

Efekti financiar, prej 20 milionë lekësh të përdoret: 10 milionë lekë të derdhen në fondin rezervë të Këshillit të Ministrave dhe 10 milionë të përdoren për plotësimin e nevojave të arsimit me tekste.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të nxjerrë udhëzimin përkatës, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Propozimi është që çmimet e shitjes me pakicë të teksteve të arsimit parauniversitar të rriten në masën 15 – 20 % kundrejt çmimeve në fuqi.

Për të krijuar një ide mbi këtë ngritje çmimesh që propozohet, po japim disa shembuj konkretë:

TITULLI	Klasa që e përdor	ÇMIMI	
TITULLI	Klasa që e përdor	Është	Bëhet
Abetare	I	70	80
Fletore e klasës së parë	I	30	40
Edukata shoqërore 1	I	60	70
Matematika 1	I	70	70
Gjuha shqipe 2	II	60	70
Leximi 2	II	60	70
Matematika 2	II	70	70
Matematika 3	III	70	70
Matematika 4	IV	70	70
Histori e kohës së re 2	X	65	80

Hyrje në filozofi	XII	80	100
Fizika 4	XII	70	90
Kimia 11	XI	75	90

Ngritja e çmimeve që propozohet në total ka një efekt ekonomik prej rreth 20 milion lekë.

Realizimin e sa kërkohet e gjykojmë të domosdoshme të bëhet, mbasi me të, me fondet e dhëna nga buxheti në formën e diferencës së çmimit, pritët një situatë relativisht më e mirë në pajisjen e nxënësve me tekste shkollore.

Në projekt janë marrë parasysh vërejtjet dhe propozimet e bëra nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë.

V E N D I M
Nr. 440, datë 9.9.1999

PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Policia e Ndërtimit funksionon në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Struktura e Policisë së Ndërtimit përbëhet nga drejtoria e saj, me qendër në Tiranë, dhe 12 degë, të organizuara në shkallë prefekturë, nga të cilat katër degë të kategorisë së parë dhe tetë të kategorisë së dytë, sipas strukturës organike, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Policisë së Ndërtimit të jetë 150 veta. Efektet e rritjes me 50 punonjës shtesë në Policinë e Ndërtimit të përballohen nga shkurtimet në sektorin e shërbimeve në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

3. Niveli i pagave për punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit në Tiranë dhe prefektura të njehsohet me nivelin e pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas tabelës nr. 2, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Punonjësit e Policisë së Ndërtimit të marrin shtesë page, për natyrë të veçantë pune, deri në masën 30 për qind mbi pagën bazë dhe një shtesë mbi pagë, për vështirësi shërbimi, në masën 30 për qind, në bazë të përcaktimit që do të bëjë Ministri i Punëve Publike dhe Transportit.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga rritja e numrit të punonjësve të Policisë së Ndërtimit në masën prej 13 (trembëdhjetë) milionë lekësh në fondin e pagave dhe 4 (katër) milionë lekë në fondin e sigurimeve shoqërore, të përballohen me fondet buxhetore të dhëna për vitin 1999 për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

6. Vendimi nr. 28, datë 17.1.1994 “Për organizimin dhe strukturën e Policisë së Ndërtimit”, vendimi nr. 468, datë 3.10.1994 “Për disa shtesa në numrin e punonjësve të Policisë së Ndërtimit”, si dhe vendimi nr. 284, datë 7.7.1997 “Për strukturën dhe organizimin e Policisë së Ndërtimit” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 443, datë, 16.9.1999

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR. 786, DATË 17.12.1998 “PËR KUALIFIKIMIN SHKENCOR, PASUNIVERSITAR DHE
KLASIFIKIMIN E PUNONJËSVE PEDAGOGJIKË E KËRKIMORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 37 të ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 17.12.1998 “Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë”, pas pikës 4.2.4 shtohen pikat 4.2.5, 4.2.6 dhe 4.2.7, me këtë përmbajtje:

“4.2.5 Në Akademinë e Arteve, kualifikimi për kategoritë e punonjësve pedagogjikë të lëndëve teorike bëhet në përputhje të plotë me pikat 4.1, 4.2, 4.2.1, 4.2.2, 4.2.3 dhe 4.2.4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 17.12.1998 “Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë”.”.

“4.2.6 “Profesor”, për lëndët speciale artistike, në Akademinë e Arteve emërohet punonjësi me një përvojë në mësimdhënie jo më pak se 14 vjet, që ka një krijimtari të shquar artistike në vazhdimësi, që është hartues programesh për lëndë ose gruplëndësh të formimit profesional, që ka drejtuar ose drejton njësi mësimore (seksion, departament, dekanat, etj.), që është autor leksionesh të shkruara ose bashkautor manualesh për Akademinë e Arteve, që ka përzgjedhur, formuar e diplomuar studentë, që tashmë shquhen për arritje në krijimtarinë artistike, brenda dhe jashtë vendit, që ka udhëhequr diploma universitare, që zotëron një gjuhë të huaj, të vërtetuar me dëshminë përkatëse, që është realizues figurash dhe veprash artistike, të gjinisë së skenës dhe të ekranit, të vlerësuara si arritje të artit tonë kombëtar (arti skenik), që ka organizuar ekspozita personale, të cilat dëshmojnë cilësi dhe nivel të lartë artistik (artet figurative), që është realizues veprash artistike, të gjinisë së muzikës, të vlerësuara si arritje të artit tonë kombëtar (muzikë), që është fitues medaljesh dhe çmimesh në krijimtari, që ka marrë pjesë, me projekte artistike, në veprimtari të rëndësishme, kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë 14 vjetëve të punës pedagogjike punonjësi mësimor-artistik duhet të ketë qenë lëvrues e realizues i jo më pak se 7 projekteve të spikatura artistike. Disa nga projektet e përcaktuara të jenë të realizuara në Akademinë e Arteve (artet figurative në Galerinë e Arteve dhe galeri të tjera, të niveleve të përafërta).”.

“4.2.7 “Profesori asociuar”, për lëndët speciale artistike, emërohet punonjësi me përvojë në mësimdhënie prej jo më pak se 10 vjetësh, që ka një krijimtari cilësore, artistike, që është hartues programesh për lëndë apo gruplëndësh të formimit profesional, që ka drejtuar ose drejton, si titullar, lëndë ose gruplëndësh të profesionit, që është hartues studimesh për problemet e fushës përkatëse, artistike (sipas specialitetit), që ka udhëhequr diploma universitare, që zotëron një gjuhë të huaj, të vërtetuar me dëshminë përkatëse, që është realizues figurash dhe veprash artistike të gjinisë së skenës dhe të ekranit, në nivele cilësore artistike (arti skenik), që ka organizuar ekspozita personale në Galerinë e Arteve dhe në galeri të tjera (arti figurativ), që është realizues veprash artistike në gjininë e muzikës, në nivele cilësore artistike (muzike), që ka realizuar 5 figura apo vepra artistike, të vlerësuara nga kritika për nivel të lartë artistik, që është vlerësuar me çmime të ndryshme në veprimtari kryesore, kombëtare ose ndërkombëtare, që krijimtaria e tij ka qenë e pranishme në procesin mësimor të Akademisë së Arteve dhe shkollave të tjera artistike, të niveleve të përafërta.”.

2. Në pikën 4.3.1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

“ - Shprehja “... prej jo më pak se 5 vjetësh...” hiqet dhe zëvendësohet me shprehjen “...prej jo më pak se 4 vjetësh...”.”.

- Shprehja “... të paktën dy disertacione...” hiqet dhe zëvendësohet me shprehjen “... të paktën një disertacion...”.”.

- Shprehja “... nga të cilat 5 jashtë shtetit...” hiqet dhe zëvendësohet me shprehjen “... brenda e jashtë shtetit ...”.”.

3. Në pikën 4.3.2 bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

“ - Shprehja “... nga të cilat 3 jashtë shtetit ...” hiqet dhe zëvendësohet me shprehjen “... brenda e jashtë shtetit...”.”.

4. Në pikat 4.5, 4.6, 4.7, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 17.12.1998, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

“ – Shprehja “Këshilli Drejtues i Akademisë” hiqet dhe zëvendësohet me shprehjen në “seksione përkatëse”. ”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 444, datë 16.9.1999

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 12, DATË 1.1.1996
“PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7971, datë 26.7.1995 “Për Prokurimin Publik”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 1.1.1996, në pikën 4, shkronja “b”, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare vlera e përlogaritur e blerjes për çdo artikull nuk është më e madhe se 600 000 lekë, brenda një viti kalendarik”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 470, datë 6.10.1999

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT QEVERTAR TË LUFTËS
KUNDËR KORRUPSIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komisionit Qeveritar të Luftës kundër Korrupsionit me këtë përbërje:

- Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar	kryetar
- Ministri i Drejtësisë	anëtar
- Ministri i Rendit Publik	anëtar
- Ministri i Financave	anëtar
- Ministri i Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin	anëtar
- Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	anëtar
- Ministri i Informacionit	anëtar
- Drejtori i Departamentit të Administratës Publike	anëtar

- Drejtori i Agjencisë së Prokurimit

anëtar

Në mbledhjet e Komisionit Qeveritar të Luftës kundër Korrupsionit ftohen të marrin pjesë edhe Prokurori i Përgjithshëm, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Shërbimit Informativ Kombëtar dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

1 Komisioni Qeveritar i Luftës kundër Korrupsionit ka për detyrë:

- të udhëheqë dhe të mbikqyrë procesin e rishikimit dhe zbatimit të planit antikorrupsion;

- të miratojë strukturën dhe përbërjen e grupeve të ekspertëve për rishikimin e planit antikorrupsion;

të përcaktojë përbërjen dhe strukturën e grupit monitorues antikorrupsion dhe t'ja paraqesë për miratim Këshillit të Ministrave;

të miratojë planin antikorrupsion, të rishikuar dhe t'ia paraqesë për miratim Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar për zbatimin dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

- Kodi Penal (i azhornuar)
- Kodi i Procedurës Penale (i azhornuar)
- Kodi Civil (i azhornuar)
- Përmbledhje të legjislacionit në fushën e transporteve (Kodi Rrugor dhe ligji për transportet)(e azhornuar)
- Kodi Zgjedhor (I azhornuar)

U dorëzua për shtyp më 8.8.2002
Doli nga shtypi më 10.8.2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendës së Publikimeve Zyrtare.
Tiranë, 2002

Çmimi: 200 lekë